


Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI – CORRUPTION AGENCY

DATË/A:	03/11/2015
REFERENC-Ë:	
PËR/ZA/TO:	z. Yll GASHI Udhëheqës i Zyrës së Prokurimit – Agjencia e Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale
CC:	z. Jeton SHALA Kryeshef Ekzekutiv - Agjencia e Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale
NGA/OD/FROM:	z. Hasan PRETENI Drejtore i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me Tenderin: " Furnizim me pajisje për LZKPPM "



Inderuari z. Gashi,

Duke u bazuar në nenin 5 paragrafi 1 nën paragrafi 1.12 të Ligjit për Agjencinë kundër Korrupsionit nr.03/L-159 dhe nenin 19 paragrafi 1, nën paragrafi 1.6 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, lidhur me tenderin: " **Furnizim me pajisje për LZKPPM** " me numër prokurimi:72000 15 019 121, Agjencia kundër Korrupsionit ofron këtë:

OPINION

Kërkohej nga ju si autoritet kontraktues që t'i ndërmerrni të gjitha veprimet e nevojshme për evitimin e shkeljeve të evidentuara në lidhje me tenderin: " **Furnizim me pajisje për LZKPPM** " në mënyrë që të respektohen dispozitat përkatëse të Ligjit nr.04 – L/042 për Prokurimin Publik.

Arsyetim

Autoriteti Kontraktues, Agjencia e Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale, bazuar në nevojën e sajë për furnizim me pajisje për LZKPPM, ka paraparë procedurë të hapur për këtë aktivitet i cili është publikuar në Komisionin Rregullativ të Prokurimit Publik më datë 14/10/2015.

Në Njoftim për Kontratë në pikën III.2.4 Kapaciteti teknik dhe profesional Autoriteti Kontraktues-AKPM ka kërkuar që pajisjet tek nënpika 4) *Të jenë të prodhuar në njërin nga shtetet Shengen, SHBA, Kanada, Japoni, Australi, Izrael, Zvicër, UK dhe këto pajisje të dëshmohen me deklaratën e origjinës së prodhuesi.*

Autoritet Kontraktues në Dosjen e Tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë ka paracaktuar vendin e origjinës për pajisjet furnizuese. Me këtë veprim, ju si autoritet kontraktues favorizoni Operator të caktuar ekonomik dhe diskriminoni të tjerë. Nëse ju si Autoritet Kontraktues iu jeni referuar Udhëzuesit Administrativ për produkte medicinale i nxjerrë nga Ministria e Shëndetësisë, Agjencia nuk ka gjetur elemente që ky udhëzim e mbulon edhe furnizimin me pajisje medicinale. Agjencia e Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale, si Autoritet Kontraktues ka obligim ligjor që ti merr gjitha masat e duhura që në aktivitetet e prokurimit mos të ketë kritere jashtë kuadrit ligjor të prokurimit publik.

Veprimet e Autoriteti Kontraktues të cekura më lartë, konsiderojmë se bien ndesh me Nenin 7, Barazia në Trajtim/Jo-Diskriminim; Nenin 27 Dosja e Tenderit, si dhe Nenin 69, Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale e Ligjit të Prokurimit publik, me nr 04/L.-042.

Konsiderojmë se shkelje të tilla, nuk duhet lejuar në procedura të prokurimit, andaj Agjencia kundër Korrupsion rekomandon anulimin e kësaj procedure të prokurimit dhe të shmangen praktika të tilla në të ardhmen.

Autoritetet Kontraktuese e informojnë Agjencinë për veprimet e ndërmarra.

Me respekt!